

vajza qan shipja edhe trenet e shpisë!” Shkaku është se çupa hikën e fluturon në shtëpin e botës, kurse djali ri në shtëpin e vet edhe hap filiza të rinj dhe kështu nuk shuhet emëri i oxhakut.

Në këtë kaptinë thamë se vajza që i kthen “shëjën” dhëndërit duhet të mos martohet deri sa të jetë gjallë ay vetë. Atëhere vajza që ri e pa martuar quhet virgjineshë dhe munt të vishet edhe me roba burri. Një vajzë munt të mbetet virgjineshë edhe në rast të një defekti të trupit, kur s’munt t’ a marë nonjeri. Në Fan kemi gjetur një vajzë 22 vjeç e cila, si pas fjalëve të saj, do mbetej virgjineshë. Kur e pyeta për shkakun, ajo më tha se nuk qe se s’desh të marë të vluarin e saj po dëshironie të rijë ke shtëpia e saj për t’ i shërbyer babës që e kish plak ashtu edhe vllaut e saj të vetëm. Me të tjera fjalë, po bënte flij veten e saj për babën edhe vëlianë. Në rasë të nonjë çnderimi që munt të bëjë një vajzë e tillë, vllau, baba, ose më të afërmit e lajnë turpin me kokën e saj. Shëndoshë plumbi!